

VENDIM
Nr. 274, datë 18.4.2012

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE BILAJ, NË KOMUNËN E BUBQIT, TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës hyrëse të shkollës 9-vjeçare Bilaj, në komunën e Bubqit, të qarkut të Durrësit.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 534 (pesëqind e tridhjetë e katër) m² tokë arë, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij projektvendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 124, 422 (njëqind e njëzet e katër mijë e katërqind e njëzet e dy) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e komunës së Bubqit, planifikuar në buxhetin e saj.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Bubqit.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Bubqit, për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të komunës së Bubqit. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 534 (pesëqind e tridhjetë e katër) m² tokë arë, shpronësuar në favor të komunës së Bubqit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen komuna e Bubqit dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha